



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 404/1 prot.

Tiranë më 5.3.2021

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 3861 Prot., datë 24.02.2021, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin "*Për rregullat e aksesimit të subjekteve të interesuara në bazën e të dhënave për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare*" dhe relacionin shoqërues, nga vlerësimi i tij, konstatohet se projektvendimi është hartuar në zbatim të ligjit nr. 154/2020 "*Për regjistrin qendror të llogarive bankare*". Për këtë të fundit, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendimin përkatës gjatë fazës së konsultimit të projektligjit nëpërmjet shkresës nr.1107/1 Prot., datë 28.09.2020.

Zyra e Komisionerit, duke shprehur vlerësimin se komentet e dhëna prej saj gjatë fazës së shqyrtimit të ligjit në lidhje me çështjen e sigurisë së të dhënave, përpunimit të drejtë të tyre, si dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave janë marrë në konsideratë në variantin përfundimtar të tij, nuk e konsideron të nevojshme përsëritjen e tyre në projektvendimin e parashtruar për mendim.

Nga ana tjetër, nisur nga përmbajtja e tij, vërejmë se në pikën 4, të Kreut 3, është parashikuar se subjektet e interesuara nuk kanë kufizime në numrin e personave që mund të autorizohen për të pasur akses në Regjistër, si dhe në numrin e kërkimeve që mund të kryejnë.

Me qëllim garantimin e parimit të mjaftueshmërisë dhe përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar, sugjerojmë që pika 4 e Kreut III, e projektvendimit të hiqet. Nga ana tjetër vlerësojmë se kjo kërkesë është adresuar në pikën 2 të Kreut II të këtij projektvendimi.

Me përfshirjen e këtij sugjerimi, projektvendimi vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

